



Misioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve nga Bashkimi Evropian në Kosovë*

Raundi i dytë i zgjedhjeve për kryetarë të komunave - 14 nëntor 2021

DEKLARATË PRELIMINARE

Raund i dytë i menaxhuar mirë pas rinumërimeve të shumta dhe konkurrencës së fortë në një fushatë dinamike

Prishtinë, 16 nëntor 2021

Kjo deklaratë preliminare e misionit të BE-së për vëzhgimin e zgjedhjeve (EU EOM) publikohet para se të përfundojë i tërë procesi zgjedhor. Mbeten pa u përfunduar fazat kritike, përfshirë tabelimin e rezultateve dhe shqyrtimin e ankesave. EU EOM tani është në pozitë të komentojë vetëm për vëzhgimet e bëra deri më sot, dhe më vonë do të publikojë raportin përfundimtar, që do të përfshijë analizën e plotë dhe rekomandimet për reformën zgjedhore. EU EOM po ashtu mund të jap deklaratatë tjera për çështjet që kanë të bëjnë me zgjedhjet siç dhe kur e konsideron të përshtatshme.

Përmbledhje

- Raundi i dytë i zgjedhjeve për kryetarë të komunave i datës 14 nëntor në 21 nga 38 komunat e Kosovës ishte konkurrues dhe i administruar mirë. Votimi dhe numërimi u vlerësuan pozitivisht nga vëzhguesit e BE-së. Fushata ishte e qetë, por me ton më të ashpër se sa në raundin e parë dhe me raste të përmbytjeve mashtruese që përhapeshin në internet. Kufizimi pesëditor i periudhës zyrtare të fushatës u shpërfill nga shumica e kandidatëve.
- Në përgjithësi, vëzhguesit e EU EOM-së e vlerësuan votimin si shumë të mirë ose të mirë në 99 për qind të vendvotimeve të vizituara, në të 21 komunat, dhe numërimin si të mirë dhe shumë të mirë në të gjitha vendvotimet e vizituara edhe pse kishte disa vështirësi me përputhshmërinë e fletëvotimeve në rreth një të tretën e vendvotime të vëzhguara.
- Tabelimi i rezultateve të raundit të parë, edhe pse i plotë dhe transparent, vuri në pah dobësi të theksuara në numërim dhe plotësimin e formularëve të rezultateve. Rezultatet e gati një mijë vendvotimeve në zgjedhjet për kryetar komune dhe kuvende komunale u desh të rinumëroheshin, që tregon nevojën për një rishikim gjithëpërfshirës të dizajnit të fletëvotimeve, fletëve llogaritëse për votat e kandidatëve dhe formularëve të rezultateve, si dhe për trajnimin e anëtarëve të Këshillave të Vendvotimeve (KVV). Para raundit të dytë të zgjedhjeve, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) zëvendësoi 806 trupa zgjedhorë, të cilët kishin performuar dobët gjatë numërimit dhe plotësimit të formularëve të rezultateve.
- Në mungesë të ndëshkimeve për zhvillim të fushatës jashtë periudhës zyrtare pesëditore, shumica e kandidatëve filluan të kërkonin votën shumë kohë para se të niste fushata zyrtare. Në tubimet e kandidatëve morën pjesë liderët e partive kryesore, përfshirë kryeministrin Albin Kurti dhe ministrat e tij, ndërsa kandidatët e LVV-së shpesh e portretizuan veten si garantues të projekteve të financuara nga buxheti qendror. Madje, mes dy raundeve, qeveria shpalli një rritje të përkohshme të përfitimeve sociale, gjë që çoi në akuza të opozitës për blerje indirekte të votës.

* Ky emërtim nuk e paragjykon qëndrimin ndaj statusit dhe është në përputhje me RKS KB 1244/1999 dhe mendimin e GJND-së për shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

- Mungesa e madhe e transparencës në lidhje me financimin e fushatave të kandidatëve vazhdoi edhe në raundin e dytë. Për shkak të zbatimit të dobët të rregullave për financimin e fushatës, Kuvendi i Kosovës nuk është në gjendje të garantojë auditimin me kohë të raporteve të paraqitura dhe KQZ-ja nuk e mbështeti sa duhet zbatimin e rregulloreve në fuqi.
- Mediat publike ofruan mbulim të balancuar të lajmeve dhe u përpoqën të organizonin debate me kandidatët për të 21 komunat, por shumica e kandidatëve zgjodhën të mos merrnin pjesë. Mediat private intervistuan rregullisht kandidatët dhe ia dolën të zhvillojnë disa debate. Në kundërshtim me ligjin, dy kanale televizive publikuan sondazhe jo të besueshme pa u ndëshkuar nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM). Duke respektuar rregulloret, mediat transmetuese u përmbajtën nga transmetimi i materialeve politike me pagesë jashtë periudhës zyrtare të fushatës zgjedhore.
- Derisa kandidatët ndanin informacione të dobishme përmes platformave online, faqe jotransparente të Facebook-ut u përdorën për të përhapur përmbajtje mashtruese që pengonin mundësinë e votuesve për të formuar opinionet pa ndërhyrje manipuluese. Kandidatët në përgjithësi përdorën reklama për të promovuar platformat e tyre të fushatës, por u përdorën shumë edhe reklamata e palëve të treta për të diskredituar konkurrentët, përfshirë edhe me akuza personale.
- Procesi i ankesave dhe parashtresave pas raundit të parë në përgjithësi u zhvillua në mënyrë transparente dhe të paanshme. Përkundër afatit të shkurtër prej 72 orësh për shqyrtim si dhe kufizimeve të burimeve teknike dhe njerëzore, Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) i gjykoi të gjitha ankesat me kohë. Vetëm një vendim i PZAP-së – për të përsëritur zgjedhjet në një komunë – ishte refuzuar nga Gjykata Supreme (GJS). Për raundin e dytë, gjashtë ankesa u parashtruan në PZAP lidhur me shkeljen e rregullave të fushatës dhe 24 për shkelje të periudhës së heshtjes zgjedhore dhe parregullsive gjatë ditës së zgjedhjeve.

Misioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve i Bashkimit Evropian (EU EOM) është i pranishëm në Kosovë që nga 5 shtatori pas ftesës nga presidentja e Kosovës. Misioni udhëhiqet nga Shefi i Misionit, Z. Lukas Mandl, deputet i Parlamentit Evropian (Austri). EU EOM shpërndau gjithsej 62 vëzhgues nga 21 shtete anëtare të BE-së, Norvegjia dhe Zvicra, në tërë Kosovën, për të vlerësuar tërë procesin zgjedhor në raport me detyrimet dhe zotimet ndërkombëtare për zgjedhje demokratike, si dhe me legjislacionin e Kosovës. Në ditën e zgjedhjeve, vëzhguesit vizituan 269 vendvotime në të 21 komunat ku u zhvillua raundi i dytë i zgjedhjeve për të vëzhguar votimin dhe numërimin. EU EOM është i pavarur në gjetjet dhe përfundimet e tyre dhe i përmbahet Deklaratës së Parimeve për Vëzhgimin Ndërkombëtar të Zgjedhjeve të nënshkruar në selinë e Kombeve të Bashkuara në tetor të vitit 2005.

Gjetjet preliminare

I. KONTEKSTI POLITIK

Njëzet e një garat për kryetar të komunës ishin të ngushta dhe konkurruese me koalicione të shumta taktike të formuara para raundit të dytë.

Pas zgjedhjeve komunale të 17 tetorit u zgjodhën anëtarët e të 38 kuvendeve komunale si dhe 17 nga 38 kandidatët për kryetarë të komunave të cilët morën mbi 50 për qind të votave të vlefshme. Pjesëmarrja në zgjedhjet e 17 tetorit në mbarë Kosovën ishte 43 për qind, por në komunat me shumicë serbe të Kosovës ajo ishte dukshëm më e lartë, 61 për qind.

Raundi i dytë i zgjedhjeve u zhvillua në 21 komunat e tjera, përfshirë edhe Prishtinën, ndërmjet dy kandidatëve kryesorë në secilën komunë. Ndërmjet dy raundeve janë krijuar një numër koalicionesh *ad hoc* në mes të subjekteve politike për të mbështetur kandidatët në raundin e dytë. Shpesh, këto ishin aleanca taktike të krijuara pavarësisht ndarjeve ideologjike dhe duke shpërfillur ekuilibrin e pushtetit në nivel qendror¹.

Në raundin e parë, kandidatët e *Listës Serbe* (SL) fituan zgjedhjet për kryetarë të komunave në nëntë nga dhjetë komunat ku serbët e Kosovës janë shumicë. Partia Demokratike e Kosovës (PDK) fitoi katër kryetarë të komunave në raundin e parë, ndërsa Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) fituan nga dy secila. Ndonëse kandidatët për kryetarë të komunave nga *Lëvizja Vetëvendosje* (LVV) në pushtet nuk fituan asnjë pozitë për kryetarë të komunave në raundin e parë, kandidatët e tyre u kualifikuan në raundin e dytë në 12 komuna. Kandidatët e LDK-së garuan në raundin e dytë në dhjetë komuna, PDK-ja në shtatë dhe AAK-ja në pesë.

Sa i përket ulëseve në kuvendet komunale, LDK-ja, PDK-ja dhe AAK-ja në përgjithësi e ruajtën gjendjen ekzistuese nga zgjedhjet e vitit 2017, ku LDK-ja dhe PDK-ja morën nga 206 ulëse dhe AAK-ja 120 ulëse. LVV fitoi 193 ulëse në kuvendet komunale, duke rritur përfaqësimin e tyre me mbi 30 për qind në dëm të partive më të vogla si Nisma Socialdemokrate (NISMA) dhe Aleanca Kosova e Re (AKR). LS me 147 ulëse dominon kuvendet komunale në komunat me shumicë serbe të Kosovës, e në disa prej tyre është e vetmja forcë politike.

Dy nga 17 kryetarët e posazgjedhur të komunave janë gra, të dyja përfaqësojnë LS-në. Vetëm një grua ishte në mesin e 42 kandidatëve në raundin e dytë. Nga 1002 këshilltarët e zgjedhur komunalë, 364 janë gra – 221 janë zgjedhur me vota të fituara dhe 143 si rezultat i mekanizmit të kuotës. Përveç nëntë kryetarëve të komunave nga radhët e serbëve të Kosovës të zgjedhur në raundin e parë, në raundin e dytë u zgjodh edhe një kryetar komune serb i Kosovës dhe një kryetar komune turk i Kosovës. Në përgjithësi, rezultati i këtyre zgjedhjeve konfirmon se votuesit i bënë zgjedhjet e tyre kryesisht në vija etnike.

II. AMBIENTI I FUSHATËS

Fushata, e cila filloi shumë para periudhës zyrtare pesëditore, ishte e qetë, por me ton më të ashpër se në raundin e parë.

Fushata e raundit të dytë filloi zyrtarisht më 8 nëntor dhe zgjati vetëm pesë ditë, deri më 12 nëntor në mesnatë, në përputhje me vendimin përkatës të KQZ-së.² Meqë as korniza ligjore nuk parashikon ndonjë ndëshkim për zhvillim të fushatës jashtë kësaj periudhe dhe as KQZ-ja nuk mori asnjë masë,³ shumica e garuesve rifilluan aktivitetet e tyre të fushatës, veçanërisht në mediat sociale, menjëherë pas raundit të parë.⁴

Partitë që janë opozitë e partisë në pushtet në Kuvendin e Kosovës shpesh formuan koalicione me këtë parti në nivel komunal.

² Megjithatë, ky vendim i KQZ-së nuk ishte në përputhje me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP) i cili parasheh 24 orë heshtje parazgjedhore para hapjes së qendrave të votimit në orën 7 të mëngjesit. Si rezultat, u vëzhgua fushata në platformat online edhe pak para orës 7 të mëngjesit të 13 nëntorit.

³ Sipas nenit 126 të LZP-së, KQZ-ja mund të kishte nxjerrë një rregullore që përcakton ndëshkimet dhe gjobat për shkeljet e dispozitave të LZP-së.

⁴ PZAP-ja hodhi poshtë ankesën e vetme në lidhje me aktivitetet e para-fushatës në mediat sociale (e paraqitur nga LDK) duke shpjeguar se mund të sanksionojë vetëm shkeljet e kodit të mirësjelljes gjatë periudhës zyrtare të fushatës.

Fushata mbeti konkurruese dhe e decentralizuar, pothuajse ekskluzivisht e udhëhequr nga personalitetet e kandidatëve dhe jo nga programet e partive të tyre politike. Infrastruktura komunale vazhdoi të jetë temë kryesore, e pasuar nga shëndetësia, arsimi, bujqësia dhe zhvillimi ekonomik. Garuesit që u takuan me EU EOM-në deklaruan se gëzonin të drejta të barabarta në lirinë e tubimit, shprehjes dhe lëvizjes.

Të gjitha aktivitetet e fushatës⁵ të vëzhguara nga EU EOM-ja u vlerësuan si të qeta edhe pse toni i fushatës ishte disi më i ashpër se në raundin e parë, kryesisht për shkak të sulmeve të ndërsjella ndërmjet kandidatëve për kryetarë të komunave. Fillimisht takimet ishin kryesisht të vogla, kryesisht në ambiente të hapura në sheshe, parqe dhe kafene. Fushata u intensifikua dy javë para ditës së zgjedhjeve me takime më të mëdha. EU EOM vëzhgoi 42 tubime të fushatës, përfshirë disa tubime me mbi 500 pjesëmarrës dhe të organizuara në ditët e fundit të fushatës.⁶ Këto tubime u zhvilluan në një atmosferë festive, duke injoruar në masë të madhe masat anti-COVID.

Në shumë tubime morën pjesë liderët kombëtarë të partive të mëdha si dhe zyrtarët qeveritarë, përfshirë kryeministrin Kurti dhe ministrat e tij. Deputetët e Kuvendit të Kosovës u angazhuan në fushatë deri në atë masë sa që disa seanca plenare të parapara të Kuvendit të Kosovës u desh të anuloheshin për shkak të mungesës së kuorumit.

Kandidatët e LVV-së e portretizuan veten si lehtësues apo edhe garantues të fondeve dhe projekteve të financuara nga buxheti qendror. Këtë mesazh e kanë përsëritur edhe kryeministri, ministrat dhe deputetët e LVV-së. Gjithashtu, mes dy raundeve, qeveria njoftoi për një rritje të përkohshme të përfitimeve sociale për muajt nëntor dhe dhjetor 2021.⁷ Derisa qeveria i prezantoi këto masa si pjesë e pakos së rimëkëmbjes ekonomike, të miratuar në qershor 2021, koha e këtij vendimi u dha një përparësi të padrejtë kandidatëve të LVV-së, në kundërshtim me praktikën e mira ndërkombëtare.⁸ Shumë bashkëbisedues të EU EOM-së ngritën shqetësime se këto masa përbënin blerje indirekte të votave dhe keqpërdorim të burimeve shtetërore nga partia në pushtet.

EU EOM vërejti shkelje të periudhës së heshtjes zgjedhore, përfshirë 33 reklama në Facebook dhe Instagram. Në ditën e heshtjes zgjedhore, kryeministri i vizitoi së paku dy komuna (Gjakovën dhe Podujevën) për tu takuar publikisht me kandidatët e LVV-së⁹.

III. FINANCIMI I FUSHATËS

Mungesa e hapur e transparencës në lidhje me financimin e fushatave të garuesve vazhdoi edhe në raundin e dytë të zgjedhjeve.

⁵ Sipas të dhënave të KQZ-së janë aprovuar gjithsej 110 tubime të kandidatëve.

⁶ Tubimet e vëzhguara me mbi 500 pjesëmarrës përfshinin: Tubimet e AAK-së në Gjakovë, Istog dhe Junik; takimi i Demokratëve për Drenasin (DD) në Glogoc; tubimet e LDK-së në Gjilan dhe Istog; të LVV-së në Gjilan, Gjakovë, Prishtinë dhe Prizren, i NISMA-s në Malishevë, të PDK-së në Malishevë, Prizren dhe Vushtrri.

⁷ Më 27 tetor, qeveria miratoi një shtesë të njëhershme prej 100 € për pensionet në nëntor dhe dyfishoi pagesat e ndihmës sociale për nëntor dhe dhjetor. Buxheti për këto masa ishte mbi 35 milionë euro dhe nga kjo pritjet të përfitojnë rreth 300 mijë familje.

⁸ Udhëzimi II.B.1.3 i Komisionit të Venedikut 2016 dhe OSBE/ODIHR [Udhëzimet e përbashkëta për parandalimin dhe reagimin ndaj keqpërdorimit të burimeve administrative gjatë proceseve zgjedhore](#) thekson se “për të parandaluar keqpërdorimin e burimeve administrative për të çekuilibruar kushtet e barabarta gjatë garave zgjedhore, korniza ligjore duhet të theksojë se nuk duhet të ndodh asnjë shpallje e rëndësishme që lidhet me, ose synon të krijojë një perceptim të favorshëm ndaj një partie apo kandidati të caktuar gjatë fushatave”.

⁹ LVV u gjobit nga PZAP-ja me € 5,100 për shkelje të periudhës së heshtjes zgjedhore.

Disa përfaqësues të shoqërisë civile dhe partive në nivel qendror dhe lokal ia përsëritën EU EOM-së shqetësimet e tyre për mbështetjen e padeklaruar financiare që partitë marrin nga bizneset. Disa gjithashtu ngritën shqetësimet se sidomos partitë kryesore i kanë tejkaluar kufijtë e shpenzimeve. Megjithatë, për shkak të mungesës së provave bindëse, ata nuk kanë ndërmend të paraqesin ankesa zyrtare.

Në cilësinë e institucionit mbikëqyrës, KQZ-ja demonstroi një konsideratë të kufizuar për çështjet e financimit të fushatës, duke kontribuar në zbatim të ulët të rregullave në fuqi. KQZ-ja ndryshoi praktikën e saj dhe e zgjati periudhën e raportimit mbi të ardhurat e fushatës nga 90 ditë në 6 muaj para zgjedhjeve. Ndonëse ky vendim e harmonizoi praktikën e KQZ-së me legjislacionin, ai iu komunikua garuesve në fund të tetorit, kur raundi i parë tashmë kishte përfunduar, duke ngritur dyshime nëse garuesit do të jenë në gjendje të zbatojnë këtë kërkesë të re. Për më tepër, KQZ-ja nuk kërkon nga garuesit të bëjnë ndarje të financave të fushatës së tyre sipas komunave, gjë që më vonë i pengon auditorët të përcaktojnë nëse janë respektuar kufijtë e shpenzimeve në një komunë të caktuar.¹⁰

Buxheti që është dashur të përdorej për auditimin e raporteve të fushatës për zgjedhjet komunale 2021 ishte shpenzuar për të bërë verifikimin e vonuar të raporteve financiare për tri vitet e fundit (2018-2020).¹¹ Sipas përfaqësuesve të Kuvendit të Kosovës, mungesa e fondeve në dispozicion, e kombinuar me mungesën e pritshme të interesimit nga auditorët e kualifikuar, mund të shkaktojë vonesa të konsiderueshme në kryerjen e auditimit. Kjo do të vazhdonte pafund modelin e procedurave të vonuara të verifikimit ku rezultatet do të ishin të disponueshme vetëm disa vite pas zgjedhjeve, duke pamundësuar kështu çdo zbatim kuptimplotë të kornizës së financimit të fushatës.

IV. ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE

Raund i dytë i organizuar mirë, por rinumërimet e shumta të rezultateve të raundit të parë vunë në pah joefikasitetin e theksuar në numërim dhe në plotësimin e formularëve të rezultateve.

Përgatitjet për raundin e dytë të zgjedhjeve për kryetarë të komunave u administruan mirë nga KQZ-ja dhe Komisionet Komunale të Zgjedhjeve (KKZ). Janë organizuar trajnime plotësuese për Këshillat e Vendvotimeve (KVV), përfshirë edhe për anëtarët e tyre që kishin punuar tashmë në raundin e parë, si dhe për anëtarët e rinj dhe ekipet mobile. Në përputhje me ligjin, KQZ-ja miratoi një formulë të re të përbërjes së KVV-së për të siguruar që kandidatët që marrin pjesë në raundin e dytë të përfaqësoheshin në KVV.

Duke e kuptuar përgjegjësinë e anëtarëve të KVV-së, të paqëllimshme ose jo, për pasaktësitë e formularëve të rezultateve që çuan në zvarritje të tabelimit, KQZ-ja zëvendësoi 806 anëtarë të KVV-ve, rezultatet e vendvotimeve të të cilëve, pas rinumërimit, kishin më shumë se një votë dallim për subjektet politike dhe/ose më shumë se tri vota dallim për kandidatët për kuvendet komunale. Për më tepër, edhe disa parti politike zëvendësuan disa anëtarë të KVV-ve të cilët i kishin emëruar për shkak të performancës së dobët gjatë numërimit në raundin e parë.

Tabelimi i rezultateve për kuvendet komunale dhe për raundin e parë të zgjedhjeve për kryetarë të komunave

¹⁰ Çdo komunë ka kufi të ndryshëm të shpenzimeve që pasqyron numrin e votuesve të regjistruar.

¹¹ Auditimi i raporteve financiare vjetore dhe pasqyrave financiare të fushatave nga viti 2018 deri në vitin 2020 filloi në korrik 2021 dhe rezultatet e auditimit janë dorëzuar në Kuvendin e Kosovës me 26 tetor.

Rinumërimet e shumta të rezultateve të vendotimeve, kryesisht të zgjedhjeve për kuvendet komunale, janë urdhëruar nga KQZ/QNR dhe, pas gjykimit të ankesave, edhe nga PZAP. Derisa niveli i lartë i verifikimit të tabelave në QNR rezultoi të jetë thelbësor për saktësinë e rezultateve, këto rinumërimet ngadalësuan ndjeshëm shpalljen e rezultateve si dhe certifikimin e tyre.

Fletëvotimet për kuvende komunale të hedhura në 341 vendotime si dhe fletëvotimet për kryetarë të komunave në 16 vendotime është dashur të rinumërohen pas pranimit të materialeve nga KKZ-të dhe pas procesit të futjes së të dhënave [në sistem]. Këto ndodhën për shkak të problemeve lidhur me numrat e ndryshuar të vulave të sigurisë së kutive të votimit, formularët e panëshkruar të rezultateve dhe mospërputhjet në mes të numrit të nënshkrimeve të votuesve në Listën e Votuesve me Kusht (LVK) dhe numrit të Zarfeve të Votimit me Kusht (ZVK), si dhe gabimeve matematikore në përputhje. Procesi i mëpastajmë i kontrollit identifikoi mospërputhje të tjera dhe vazhdoi me rinumërimet e reja për një varg arsyesh, kryesisht për shkak të mospërputhjeve në fletët e rezultateve të zgjedhjeve për kuvendet komunale ndërmjet numrit të votave të marra nga subjektet politike (Formulari i përputhjes së rezultateve - FPR) dhe nga kandidatët e tyre (Formulari i Rezultateve të Kandidatëve – FRK).

KQZ-ja i shpalli rezultatet e zgjedhjeve për kryetarë të komunave më 28 tetor dhe i certifikoi ato për 34 komuna më 29 tetor. Pas shqyrtimit të ankesave nga PZAP-ja, rezultatet për kryetar të komunës në tri komunat e mbetura u certifikuan më 3 nëntor. Rezultatet për kryetar të komunës së fundit u certifikuan më 5 nëntor, ndërsa rezultatet për kuvendet komunale u shpallën gjithashtu po të njëjtën ditë. Pas shqyrtimit të ankesave të shumta kundër rezultateve të zgjedhjeve për kuvendet komunale, PZAP-ja urdhëroi rinumërimin edhe të 630 vendotimeve të tjera. Këto rinumërimet, në mënyrë të veçantë, bënë që procesi i tabelimit të vazhdojë deri në mbrëmjen e raundit të dytë të zgjedhjeve të 14 nëntorit.

Numri i madh i rinumërimet të rezultateve të zgjedhjeve për kuvendet komunale jo vetëm që tregon për një problem serioz në përputhjen dhe plotësimin e formularëve të rezultateve nga anëtarët e KVV-së, shumica dërrmuese e të cilëve e kishin kaluar me sukses provimin me shkrim pas trajnimit të tyre për raundin e parë, por edhe për gabimet gjatë bartjes së të dhënave nga fletët llogaritëse të votave të kandidatëve në FRK dhe sjelljen jo të mirë të mundshme nga disa anëtarë të KVV-së.¹²

Numri i fletëvotimeve të pavlefshme në raundin e parë të zgjedhjeve për kryetarë të komunave, sipas llogaritjeve të EU EOM-së bazuar në të dhënat e ndara sipas komunave të publikuara nga KQZ-ja, ishte 1.6 për qind dhe numri i fletëvotimeve të zbrazëta afër 1 për qind. Nga ana tjetër, numri i fletëvotimeve të pavlefshme për zgjedhjet për kuvendet komunale arriti në pothuajse 7 për qind, duke treguar për aktivitete të pamjaftueshme për informimin e votuesve ose dizajn tepër të ndërlikuar të fletëvotimeve, dhe numri i fletëvotimeve të zbrazëta në 1.6 për qind.

Në përgjithësi, vëzhguesit e BE-së e vlerësuan tabelimin si transparent dhe të organizuar mirë. Aktivitetet në QNR u zhvilluan në prani të vëzhguesve të subjekteve politike, të cilët nuk parashtruan ankesa kundër procesit të tabelimit dhe nuk raportuan ndonjë problem tek vëzhguesit e EU EOM-së. Për të rritur transparencën, QNR-ja kishte vendosur 50 kamera në tabelat e futjes së të dhënave dhe të numërimit, si dhe duke ndarë edhe raportet ditore të progresit dhe të dhëna të detajuara për çdo pjesë të procesit me palët e interesuara. Megjithatë, të dhënat nuk ishin gjithmonë të strukturuar në mënyrë që do të lehtësonte analizën dhe ndërlikohet ndërmjet grupeve të ndryshme të të dhënave ndonjëherë ishin të paqarta, duke e vështirësuar vlerësimin e koherencës së tyre.

¹² Sipas raportit përfundimtar të KQZ-së për aktivitetet e trajnimit, nga 14,855 anëtarë të KVV-ve që janë trajnuar për raundin e parë, vetëm 20 nuk e kishin kaluar provimin me shkrim.

EU EOM ka analizuar fletët e rezultateve të zgjedhjeve për kuvendet komunale të vendvotimeve ku është bërë rinumërimi për shkak të mospërputhjeve në formularët e rezultateve në mes të votave të subjekteve politike (FPR) dhe votave të kandidatëve (FRK).¹³ Në to, EU EOM identifikoi një model gabimesh nga të cilat përfituan të gjitha subjektet politike, por kryesisht ato kryesoret.¹⁴ Në mënyrë të veçantë, në shumicën e këtyre vendvotimeve, gjatë plotësimit të FRK-ve disa kandidatëve iu atribuuan më shumë vota se sa ato që kishin marrë realisht dhe ky numër më i lartë ishte kryesisht identik me numrin e tyre rendor në fletën e votimit. Ky model tregon për një gabim të mundshëm njerëzor për shkak të lodhjes dhe kompleksitetit të fletëve për llogaritjen e votave të kandidatëve dhe FRK-ve, megjithëse nuk mund të përjashtohen raste të izoluar kur kjo bëhej me qëllim.

Meqë verifikimi i saktë i tabelimit është i domosdoshëm për pranimin e rezultateve nga palët e interesuara zgjedhore dhe për besimin e tyre në procesin zgjedhor, totali i 987 rinumërimeve të bëra për raundin e parë të zgjedhjeve (ose 40 për qind) nxjerr në pah nevojën për një rishikim gjithëpërfshirës të dizajnit të fletëvotimeve, fletëve të llogaritjes së votave të kandidatëve dhe formularëve të rezultateve, si dhe të kritereve për rekrutimin, si dhe trajnimin e anëtarëve të KVV-ve.

V. KONTESTET ZGJEDHORE

Procesi i ankesave dhe parashtresave në përgjithësi u zhvillua në mënyrë transparente dhe të paanshme, përkundër afatit shumë të shkurtër për shqyrtim.

Procesi i ankesave dhe parashtresave në përgjithësi është zhvilluar nga PZAP-ja në mënyrë transparente dhe të paanshme. Për raundin e parë, PZAP-ja ka pranuar 40 ankesa lidhur me shkeljen e heshtjes zgjedhore dhe ndalimin e bërjes së fushatës në ditën e zgjedhjeve, shumica e të cilave kanë të bëjnë me rrjetet sociale. PZAP-ja i pranoi 24 prej tyre dhe shqiptoi gjopa në vlerë të përgjithshme prej €12,550 për gjashtë subjekte politike. EU EOM i vlerësoi këto vendime si të bazuara.

Janë paraqitur pesëdhjetë e tetë ankesa në lidhje me votimin, numërimin dhe procesin e tabelimit si për zgjedhjet për kryetarë të komunave ashtu edhe për kuvende komunale në raundin e parë, dhe PZAP-ja i hodhi poshtë 37 prej tyre si të papranueshme.¹⁵ Trembëdhjetë ankesa u refuzuan pasi nuk ishin paraqitur dëshmi përkatëse, në gjashtë raste PZAP-ja i pranoi pjesërisht ankesat dhe i ndëshkoi disa nga anëtarët e KVV-ve për parregullsi të vogla dhe një ankesë është refuzuar për dorëzim pas afatit. Vetëm një ankesë është pranuar plotësisht – PZAP-ja çuditërisht anuloi rezultatet e zgjedhjeve për kryetar në komunën e Hanit të Elezit për shkak të pretendimit për blerje votash dhe presionit ndaj votuesve nga kandidati i PDK-së për kryetar. Kjo ishte ankesa e vetme që sipas analizës së EU EOM-së nuk ishte gjykuar mirë nga PZAP-ja pasi që provat e ofruara nga ankuesi ishin të dobëta dhe arsyetimi ligjor i PZAP-së ishte i mangët. Vendimi u anulua nga Gjykata Supreme (GJS) pas ankesës së PDK-së dhe lënda iu kthye për rigjykim një

¹³ Në veçanti, EU EOM analizoi fletët e rezultateve të 291 vendvotimeve ku QNR/KQZ-ja urdhëruan rinumërimin dhe u fokusua në këto rezultate ku kandidatët kishin marrë numër më të madh të votave se subjekti i tyre politik (rezultatet e 154 vendvotimeve nga 291).

¹⁴ PDK, LDK, LVV dhe AAK dhe herë pas here NISMA dhe AKR.

¹⁵ Korniza ligjore nuk parasheh parashtrimin e ankesave kundër rezultateve përfundimtare, por vetëm ankesa lidhur me votimin dhe numërimin në vendvotime dhe për procesin e tabelimit në QNR brenda një afati prej 24 orësh. PZAP-ja e pranon këtë anomali dhe, në praktikë, i refuzon ankesat e tilla si të papranueshme ose të parakohshme, por i lejon ankuesit t'i dorëzojnë sërish ato pasi KQZ-ja të shpallë rezultatet përfundimtare.

paneli të ri të PZAP-së që e gjobiti PDK-në me €10,100 për thyerjen e heshtjes zgjedhore. GJS-ja e la në fuqi vendimin.

Pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të raundit të parë në zgjedhjet për kryetarë të komunave, në PZAP brenda afatit prej 24 orësh u paraqitën pesë ankesa për mospërputhje të ndryshme apo manipulime të supozuara të rezultateve në pesë komuna. Katër prej tyre u refuzuan dhe një u miratua pjesërisht nga PZAP-ja dhe PZAP-ja e gjobiti *Listën Serbe* me €8,100 për shkelje të Kodit të Sjelljes në Kllokot.¹⁶ GJS-ja e la në fuqi vendimin.

Pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve për kuvendet komunale, në PZAP u dorëzuan 352 ankesa me pretendimin për gabime në numërim ose për mospërputhje të ndryshme ndërmjet formularëve të rezultateve të vendotimeve dhe rezultateve përfundimtare të KQZ-së. Pavarësisht afatit të shkurtër prej 72 orësh për marrjen e vendimeve si dhe kufizimeve teknike dhe burimeve njerëzore, PZAP-ja i gjykoi me kohë të gjitha ankesat, duke nxjerrë 92 vendime për 630 rinumërimet, përfshirë edhe rinumërimet pothuajse të plota në Podujevë dhe Mitrovicë të Jugut. Megjithatë, në shumë raste, shkalla e gabimeve të pretenduara nga ankuesit do të ishte e pamjaftueshme për të përmbysur rezultatin, dhe provat e ofruara ndonjëherë ishin të kufizuara ose nuk ishin të përshkruara qartë në arsyetimin ligjor të vendimit.

Ankesat e tjera kundër rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve për kuvendet komunale përgjithësisht u refuzuan nga PZAP-ja për mungesë provash. Kundër këtyre vendimeve janë parashtruar 26 ankesa në GJS, e cila i refuzoi 24 prej tyre si të pabazuara, pasi ankuesit nuk kishin ofruar prova për pretendimet e tyre dhe një pasi që është dorëzuar pas afatit 24 orësh. Vetëm një ankesë u pranua dhe GJS urdhëroi KQZ-në të verifikojë votat e fituara nga ankuesi.¹⁷ Sipas analizës së EU EOM-së, vendimi është i bazuar, meqë vërtetë mund të identifikoheshin disa mospërputhje kur krahasoheshin FRK-të me rezultatet përfundimtare.

Sa i përket fushatës për raundin e dytë, në PZAP u parashtruan gjashtë ankesa lidhur me shkeljen e rregullave të fushatës, përfshirë përdorimin e fëmijëve në aktivitete të fushatës dhe vendosjen e gabuar të materialit të fushatës. Janë bërë 24 ankesa për shkelje të periudhës së heshtjes zgjedhore dhe parregullsi gjatë ditës së zgjedhjeve.

VI. MEDIA

Mediat publike u përpoqën të organizonin debate me kandidatët për të 21 komunat dhe ofruan një mbulim të balancuar, ndërsa transmetuesit privatë kontribuan pozitivisht në informimin e votuesve duke mbajtur disa debate dhe intervista me kandidatët, dhe në përgjithësi i respektuan rregulloret.

Para fillimit të fushatës zgjedhore për raundin e dytë, kanalet e monitoruara televizive mbuluan në masë të madhe në lajmet e tyre shpalljen e rezultateve preliminare të raundit të parë dhe aktivitetet e KQZ-së dhe QNR-së. Në programet e tjera redaktuese, transmetuesit privatë filluan menjëherë të fokusohen në

¹⁶ Më 29 tetor, u parashtrua një ankesë nga GI *Srpska Narodna Sloga* kundër *Listës Serbe* në Kllokot duke denoncuar praktikat e blerjes së votës nga katër persona, të cilët u arrestuan për këtë shkelje zgjedhore dhe aktualisht janë nën aktakuzë. Mbi këtë bazë PZAP-ja e aprovoi pjesërisht ankesën dhe e shqiptoi gjobën.

¹⁷ GJS urdhëroi KQZ-në të verifikojë votat e fituara nga ankuesi, Dardan Krasniqi (Demokratët për Drenasin), bazuar në FRK-të e të gjitha vendotimeve të komunës së Gllogocit, për shkak të mospërputhjeve ndërmjet numrit të votave që ankuesi kishte në FRK dhe rezultateve përfundimtare të publikuara nga KQZ-ja. Sipas analizës së EU EOM-së, ka vërtet një mospërputhje prej 10 votash në formularin e rezultateve të një vendvotimi pas rinumërimit të bërë nga QNR më 25 tetor, krahasuar me FRK-në origjinale.

raundin e dytë duke transmetuar intervista me kandidatët për kryetarë të komunave dy ditë pas raundit të parë dhe debate zgjedhore pak më vonë.¹⁸

Gjatë fushatës, kanali i parë televiziv publik i kushtoi dukshëm më shumë mbulim të lajmeve për garat komunale sesa transmetuesit privatë, raportimi i lajmeve nga ai mbuloi shumicën e komunave dhe u tregua i balancuar.¹⁹ Kanalet televizive publike *RTK1* dhe *RTK2* u përpoqën të organizojnë debate zgjedhore për të 21 komunat gjatë fushatës zgjedhore pesëditore, por patën sukses vetëm në dy raste, ku shumica e debateve u kthyen në intervista me një kandidat, pasi kundërshtari nuk mori pjesë. Përkundrazi, kanalet televizive private, të cilat filluan shumë përpara fushatës zyrtare zgjedhore, patën sukses në organizimin e disa debateve të tjera. Domethënë, në mes të dy raundeve, *TV Dukagjini* transmetoi trembëdhjetë debate, *Kanali 10* nëntë debate, dhe *Klan Kosova* pesë.²⁰ Përveç kësaj, kanalet televizive private u ofruan kandidatëve që nuk ishin të interesuar për debate mundësinë për tu intervistuar individualisht. Shumica e debateve dhe intervistave u transmetuan drejtpërdrejt në faqet e kanaleve televizive në Facebook. Para raundit të dytë, toni i debateve u bë më i tensionuar, me sulme dhe akuza të ndërsjella në rritje ndërmjet garuesve, ndonjëherë me moderim të kufizuar nga drejtuesit e TV-ve.²¹ Faqet e lajmeve në internet ofruan një mbulim të kufizuar ose të njëanshëm të garave komunale. Bashkëbiseduesit e EU EOM-së raportuan praktikën e faqeve të lajmeve në internet për tu ofruar garuesve mbulueshmëri me lajme me pagesë pa i shënuar artikujt e publikuar në faqet e tyre të internetit si të paguara.

Dispozitat e LZP-së për mbulimin e zgjedhjeve në mediat elektronike zbatohen vetëm për periudhën zyrtare pesë-ditore të fushatës, duke përfshirë rregullat e detajuara për përmbajtjen politike me pagesë dhe kushtet për ofrimin e kohës së transmetimit falas për subjektet politike. Megjithatë, kanalet televizive të monitoruara respektuan rregulloren e KPM-së, e cila në mënyrë eksplicite ua ndalon mediave të transmetojnë përmbajtje politike me pagesë jashtë periudhës së fushatës.²² Transmetuesit po ashtu në përgjithësi e respektuan rregulloren që ka të bëjë me zgjedhjet gjatë fushatës. Megjithatë, *TV Dukagjini* dhe *Kanali 10* publikuan dhe komentuan në programet e tyre rezultatet e sondazheve zgjedhore të zhvilluara përmes faqeve të tyre në Facebook, të cilat ishin në kundërshtim me kërkesat ligjore, duke çorientuar potencialisht votuesit dhe duke dëmtuar kandidatët.²³ Përderisa KPM-ja, gjatë periudhës së fushatës për raundin e dytë, i ndëshkoi me kohë transmetuesit për shkelje të tjera të ligjit për zgjedhjet, ai nuk i ndëshkoi transmetuesit për shkeljen e dispozitës për publikimin e sondazheve gjatë të dy periudhave të fushatës.²⁴

¹⁸ EU EOM-ja vazhdoi monitorimin e pesë kanaleve televizive, një mostër të mediave të lajmeve online si dhe faqeve të tyre në Facebook ndërmjet dy raundeve të zgjedhjeve.

¹⁹ Gjatë fushatës zyrtare zgjedhore pesëditore, *RTK1* ia kushtoi 26 për qind të mbulimit të saj të lajmeve në kohën kryesore të transmetimit LVV-së, 21 për qind PDK-së, 20 për qind LDK-së dhe 14 për qind AAK-së.

²⁰ Debatet zgjedhore në *TV Dukagjini* u organizuan nga zyra e Rrjetit Ballkanik të Gazetarisë Hulumtuese (BIRN) në Kosovë. Dy kanalet televizive, *Klan Kosova* dhe *TV Dukagjini*, arritën të organizojnë nga një debat për garën për kryetar të Prishtinës.

²¹ Për shembull, akuzat politike të shkëmbyera në debatin për Komunën e Kaçanikut të transmetuar nga *Kanali 10* me 31 tetor të vitit 2021 bënë që kandidati i PDK-së të padisë kandidatin e LVV-së për shpifje.

²² Neni 2.2 dhe Neni 14.6 i Rregullores për Komunikime Komerciale Audiovizuale KPM-2017/07.

²³ Neni 47.5 i LZP-së, kërkon që hulumtimet e opinionit të publikuara nga transmetuesit të përfshijnë informacione “për numrin e gjithëmbarshtëm të respondentëve, emrin e kompanisë realizuese, emrin e partisë përgjegjëse për atë hulumtim, dhe margjinën e gabimit.” Udhëzimet e KPM-së e specifikojnë që “Termet hulumtim dhe anketë përdoren për të përfshirë çdo raportim të matjeve të mbështetjes së publikut apo qëndrimeve ndaj subjekteve politike të certifikuara, apo çfarëdo që ka të bëjë me zgjedhjet”.

²⁴ Më 18 dhe 20 tetor, KPM-ja ndëshkoi transmetuesit për që kishin ndodhur gjatë fushatës zgjedhore të raundit të parë. Më 11 nëntor, KPM-ja ndëshkoi *Kanalin 10* dhe *T7* për shkelje të nenit 49.6 të LZP-së (Mosetiketimi i duhur i përmbajtjes politike të paguar) gjatë fushatës së raundit të dytë.

VII. KOMUNIKIMI DIGJITAL DHE MEDIET SOCIALE

Derisa kandidatët ndanë informacione të dobishme përmes platformave online, faqe jotransparente të Facebook-ut u përdorën për të shpërndarë përmbajtje çorientuese që pengonin votuesit për të formuar opinione pa ndërhyrje manipuluese.

Ndonëse fushata filloi zyrtarisht më 8 nëntor, fushata në internet rifilloi menjëherë pas raundit të parë. Garuesit përdorën platformat online për të promovuar politikën e tyre dhe për të mobilizuar elektoratin. LVV-ja mbeti partia më aktive në Facebook, e ndjekur nga PDK-ja dhe LDK-ja. Të tri partitë bënë fushatë kryesisht përmes faqeve të tyre kryesore në Facebook dhe faqeve të administruara nga degët e tyre nëpër komuna, si dhe përmes llogarive zyrtare dhe personale të kandidatëve të tyre. Në masë më të vogël, për fushatë u përdor edhe Instagrami. EU EOM vërejt një shtim të postimeve të fushatës që i adresoheshin elektoratit të diasporës në rrjetet sociale krahasuar me raundin e parë.

Ndryshe nga retorika e qetë e vërejtur para raundit të parë, toni i fushatës digjitale u bë më negativ. Disa kandidatë përdorën Facebook-un dhe Instagramin për t'iu drejtuar kundërshtarëve me gjuhë të ashpër, ndonjëherë duke u përpjekur t'i de-legjitimonin ata. Në mes dy raundeve është vërejtur një rritje e vazhdueshme e reklamave në Facebook nga kandidatët, partitë politike dhe palët e treta. Një analizë e përmbajtjes së tyre tregoi se, derisa kandidatët në përgjithësi përdorën reklamat për të promovuar platformat e fushatës së tyre, reklamat zgjedhore të palëve të treta u përdorën kryesisht për të diskredituar garuesit, përfshirë edhe me akuza personale.²⁵

EU EOM vërejt një përdorim qëllimqëq të faqeve në Facebook për të diskredituar garuesit. Disa nga këto faqe u krijuan gjatë gjashtë javëve para raundit të dytë ose e ndryshuan emrin e tyre menjëherë pas raundit të parë, duke ofruar të dhëna të pamjaftueshme për identifikimin e administratorëve të tyre, gjë që dobësoi aftësinë e votuesve për të dalluar burimet e tyre të informacioneve politike për të marrë vendim plotësisht të informuar.

Këto faqe jotransparente sponsorizuan shumë postime që u drejtoheshin garuesve me retorikë negative. Duke mos qenë pjesë e fushatës zyrtare të kandidatëve, ato kontribuan në krijimin e një çrregullimi informativ, pa transparencë se kush paguante për to. Këto faqe kishin për qëllim të çorientonin votuesit, duke ndikuar negativisht në të drejtën e tyre për të formuar opinione për një çështje politike pa ndikim manipulues.²⁶ Pavarësisht se kjo praktikë binte ndesh me standardet e komunitetit të tij, Facebook nuk i hoqi këto faqe mes dy raundeve.²⁷

VIII. VËZHGIMI I ZGJEDHJEVE

²⁵ Njësia për media sociale e EU EOM-së përcolli çdo ditë në mënyrë manuale reklamat zgjedhore me pagesë në Facebook dhe Instagram.

²⁶ Shih Komitetin e Kombeve të Bashkuara (OKB) për të Drejtat e Njeriut, Komentin e Përgjithshëm nr. 25, paragrafin 19: "Votuesit duhet të jenë në gjendje të formojnë opinione në mënyrë të pavarur, pa dhunë apo kërcënim për dhunë, detyrim, nxitje apo ndërhyrje manipuluese të çfarëdo lloji."

²⁷ "Në përputhje me përkushtimin tonë për autenticitet, ne nuk i lejojmë njerëzit të paraqesin veten rrejshëm në Facebook, të përdorin llogari të rreme, të rrisin artificialisht popullaritetin e përmbajtjes ose të përfshihen në sjellje të dizajnuara për të mundësuar shkelje të tjera sipas Standardeve tona të Komunitetit. [...] Mos: [...] Fshihni qëllimin e një faqeje duke mashtruar përdoruesit në lidhje me pronësinë ose kontrollin e asaj faqeje", Qendra e Transparencës në Facebook, Sjellja joautentike: [Sjellja joautentike | Qendra e Transparencës \(fb.com\)](#).

Vëzhguesit vendorë që përfaqësonin garuesit dhe shoqërinë civile e rritën transparencën.

Koalicioni Demokracia në Veprim shpërndau rreth 100 vëzhgues të shoqërisë civile në ditën e zgjedhjeve, si në raundin e parë. Vetëm gjysma e vëzhguesve të organizatave të shoqërisë civile të akredituara për raundin e parë e konfirmuan në KQZ pjesëmarrjen e tyre edhe në raundin e dytë, ndërsa u akredituan 12 vëzhgues të rinj të OSHC-ve. Subjektet politike akredituan 814 vëzhgues të tjerë shtesë dhe u duhej të konfirmonin në KQZ edhe përfaqësuesit e tyre që tashmë ishin akredituar për raundin e parë.²⁸

IX. VOTIMI DHE NUMËRIMI

Votimi dhe numërimi u vlerësua si i mirë ose shumë i mirë në pothuajse të gjitha vendvotimet e vizituara.

Në përgjithësi, vëzhguesit e EU EOM-së e vlerësuan votimin si shumë të mirë ose të mirë në 99 për qind të vendvotimeve të vizituara, në të 21 komunat. Hapja e qendrave të votimit është vëzhguar në 19 nga 21 komunat ku mbahej raundi i dytë i zgjedhjeve. Vëzhguesit e BE-së raportuan se shumica e vendvotimeve u hapën me kohë ose me një vonesë të shkurtër prej më pak se 10 minutash. Kryesuesi i KVV-së në 81 për qind të vendvotimeve të vizituara ishte mashkull.

Votimi gjatë gjithë ditës ka vazhduar në mënyrë të qetë dhe të rregullt, përveç incidenteve të izoluara në Junik.²⁹ Dy persona u arrestuan për blerje të pretenduar të votës në Kamenicë.

Në të gjitha qendrat e votimit të vizituara është respektuar fshehtësia e votës. Megjithatë, në 13 për qind të vizitave, votuesit me dokumente të skaduara të identifikimit të Kosovës nuk janë lejuar të votojnë, ndërsa në shumë vendvotime të vizituara janë pranuar lloje të ndryshme të dokumenteve të skaduara të identifikimit të votuesve (përfshirë pasaportat dhe patentë shoferët), të gjitha këto në mospërputhje me vendimin përkatës të KQZ-së. Vetëm 65 për qind e vendvotimeve dhe qendrave të votimit të vëzhguara ishin të qasshme për votuesit me mundësi të zvogëluar të lëvizjes, ndërsa struktura e vendvotimeve ishte e përshtatshme për votuesit me karrocë në rreth 85 për qind të vendvotimeve të vizituara. Fletët e votimit me prekje [në alfabetin Braille] nuk ishin në dispozicion në 33 për qind të qendrave të vizituara të votimit.

Votimi i asistuar ishte regjistruar në librat e votimit në 70 për qind të vendvotimeve të vizituara. Mosnjohja e procedurave të votimit, moshja e shtyrë, shikimi i dobët dhe analfabetizmi përbënin shumicën dërrmuese të arsyeve të paraqitura për votim të asistuar. Votimi në grup/familjar u vërejt në 6 për qind të vendvotimeve të vizituara. Prania e vëzhguesve të akredituar të subjekteve politike gjatë votimit është vërejtur në 97 për qind të vendvotimeve të vizituara, ndërsa vëzhgues të shoqërisë civile në vetëm 4 për qind.

Numërimi është bërë në mënyrë transparente me vëzhgues të partive politike të pranishëm në të 22 vendvotimet ku EU EOM-ja e vëzhgoi numërimin; vëzhguesit e shoqërisë civile ishin të pranishëm vetëm në dy nga vendvotimet e vizituara. Procedurat lidhur me përputhjen e fletëvotimeve nuk janë respektuar plotësisht në rreth një të tretën e 22 vendvotimeve të vizituara, që rezultoi në vështirësi në plotësimin e FPR-ve në tri prej atyre vendvotimeve. Megjithatë, procesi i përgjithshëm i numërimit u vlerësua si shumë i mirë në 64 për qind dhe i mirë në 36 për qind të vendvotimeve të vëzhguara.

²⁸ Sipas nenit 54.1 të LZP-së, “subjektet e certifikuara politike, OJQ-të dhe organizatat qeveritare dhe ndërqeveritare si dhe organizatat ndërkombëtare (...) kanë të drejtë të kërkojnë akreditimin e vëzhguesve”; prandaj ligji bën një dallim në përdorimin e fjalës “vëzhgues” bazuar në faktin nëse ata përfaqësojnë subjekt politik ose organizatë të shoqërisë civile.

²⁹ I biri i kandidatit të LDK-së e kërcënoi menaxherin e qendrës së votimit se ia ndaloi hyrjen në qendrën e votimit (ai nuk ka qenë vëzhgues i akredituar). Në një rast tjetër, një ish-deputet i LVV-së është grindur me një zyrtar të zgjedhjeve. Në të dyja rastet është dashur të ndërhyjë policia.

Procedurat e pranimit të materialit në KKZ u vlerësuan si të mira, të shpejta dhe efikase nga të gjithë vëzhguesit e BE-së. Në gjashtë nga 20 KKZ-të e vizituara nga vëzhguesit e BE-së është dashur të bëhen korrigjime lidhur me materialet që nuk ishin paketuar si duhet dhe formularët e rezultateve që nuk ishin plotësuar tërësisht. Nuk janë vërejtur gabime procedurale në asnjë prej KKZ-ve të vizituara. Në përgjithësi, vëzhguesit e BE-së vlerësuan procesin e pranimit të materialeve si shumë të mirë në 80 për qind të rasteve dhe si të mirë në pjesën tjetër prej 20 për qind të KKZ-ve të vizituara.

Kjo deklaratë duhet të lexohet e ndërlidhur me Deklaratën e EU EOM-së të datës 19 tetor. Versionet elektronike të të dy deklaratave janë në dispozicion në faqen e internetit të Misionit: [Kosova2021.eueom.eu](https://www.kosova2021.eueom.eu)

Për më shumë informata, ju lutemi kontaktoni: **Marek.Mracka**, Zyrtar për Media i EU EOM,
Telefoni: 383 48 798 326, Email: marek.mracka@eueomkosovo2021.eu

Misioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve i Bashkimi Evropian
Rr. Murat Mehmeti 1 – 3, Tophane 10000, Prishtinë, Kosovë
